



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1509/1094/BA/dk

## VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA

në çështjen e Ankesës nga

IPKO

(“Palë ankuese”)

I përfaqësuar nga:  
Znj. Blinera Osmani  
Z. Dardan Makolli  
Z. Blerim Halimi

kundër Vendimit të

Komisionit të Komisionit të Pavarur të Media

(“KPM”)

në Ankesën 2015/42

(Vendimit të Komisionit të KPM-së të datës 2 qershor 2015)

### Faktet

1. Me vendimin e tij 2015/42 të datës 2 qershor 2015 (Ref: 1505/699/LEG/hzg), Komisioni i KPM-së konstatoi se operatorët kabllorë të cilët bartin platformën TRING TV, kanë siguruar marrëveshjet për përmbajtjet programore të platformës TRING TV për territorin e Republikës së Kosovës, duke vepruar kështu në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Komisionit konstatoi se ankesat e Palës Ankuese, përmes të cilave pretendohet se operatorët kabllorë nuk kanë të drejtë që kontentin e platformës TRING TV ta bartin për territorin e Kosovës janë të pabazuara.
2. Me datën 15 qershor 2015, brenda afatit ligjor, Pala Ankuese ka parashtruar Ankesë para Bordit për Ankesa kundër Vendimit të Komisionit të KPM-së. Pala Ankuese në ankesën e saj thekson se: *Vendimi i Komisionit të KPM-së ka bërë shqyrtim të pjesërishëm të ankesave të IPKO-s dhe përkundër faktit që IPKO ka bërë ankesa individuale për secilin operator veç e veç, Komisioni i KPM-së ka marrë vetëm një Vendim të vetëm duke i shqyrtuar të gjitha ankesat e IPKO-s në një Vendim.*



3. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 5 gusht 2008, ka vendosur që Palës Ankuese t'i lëshojë licencën për të operuar si operator kabllor, në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Bordi për Ankesa gjen se Pala Ankuese në mënyrë të vazhdueshme ka parashtruar ankesa kundër operatorëve kabllor të cilët bartin platformën e TRING TV në territorin e Republikës së Kosovës.
5. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 31 mars 2015 dhe 2 prill 2015 ka pranuar nëntë ankesa të parashtruara nga Pala Ankuese kundër nëntë operatorëve kabllorë: ELEKTRA, EURINA, ORANGE NET, NEGE NET, KUMANOVA, VISTA, KUJTESA NET, EGC DHE ART MOTION. IPKO pretendon se këta operatorë janë duke transmetuar përmbajtje programore, përkatësisht filma, të cilët i bartin përmes platformës Tring TV, pa të drejta autoriale. Filmat e cekur në ankesa për të gjithë operatorët kabllorë janë: Public Enemies, Robin Hood, People I Know, Mr. Bean's Holiday, I Now Pronounce You Chuck and Larry Jeff, Who Lives at Home, Madagaskar, Escape 2 Africa, The English Teacher dhe Broken City.
6. Bordi për Ankesa gjen se KPM me datën 10 prill 2015, ka njoftuar Palwn Ankuese, se pas vlerësimit të kontratave të TRING TV për filmat e përmendur në ankesat e datës 31 mars dhe 2 prill 2015, është konstatuar se Tring TV ka siguruar të drejtat për filmat: Public Enemies, Mr. Bean's Holiday, I Now Pronounce Chuck and Larry dhe Broken City për territorin e Republikës së Kosovës. Kurse, në kontratat e Palës Ankuese nuk është gjetur filmi Broken City.
7. Bordi për Ankesa gjen se Pala Ankuese me datën 10 prill 2015, ka paraqitur sërish nëntë ankesa për të njëjtët operatorë kabllorë: ELEKTRA, EURINA, ORANGE NET, NEGE NET, KUMANOVA, VISTA, KUJTESA NET, EGC DHE ART MOTION, me të njëjtin pretendim të transmetimit të përmbajtjeve programore, përkatësisht filmave si në vijim: Spy Game, Ghost, Inglourious Basterds, Lord of War, Billy Eliot, Eastern Promises, Jerry Maguire dhe Dr, Seuss How the Grinch Stole Christmas.
8. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 15 prill 2015, duke u bazuar në ankesat e Palës Ankuese të datës 10 prill 2015, ka kërkuar nga operatorët kabllorë: ELEKTRA, EURINA, ORANGE NET, NEGE NET, KUMANOVA, VISTA, KUJTESA NET, EGC DHE ART MOTION, që në afat prej pesë ditësh t'i deponojnë në KPM kontratat përmes të cilave dëshmojnë se Tring TV ka të drejtë që filmat e lartpërmendur t'i bartë në territorin e Kosovës.
9. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 16 prill 2015, përmes një shkrese e ka njoftuar Palën Ankuese lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë KPM pas ankesave të datës 10 prill 2015, duke e njoftuar se Tring TV ka siguruar të drejtat për filmat: Lord of the Ware dhe Billy Elliot. Po ashtu, KPM e ka njoftuar Palën Ankuese edhe për kërkesën që ua ka drejtuar operatorëve kabllorë që në afat prej pesë ditësh t'i deponojnë në KPM kontratat që dëshmojnë se Tring TV ka të drejtë t'i bartë filmat në territorin e Kosovës, filmat si në vijim: Spy Game, Ghost, Inglourious Basterds, Eastern Promises, Jerry Maguire dhe Dr, Seuss How the Grinch Stole Christmas.
10. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 20 prill 2015, ka pranuar përgjigje nga TRING TV në lidhje me kërkesën e KPM-së, duke sjellë kontratat për filmat: Spy Game, Ghost,



Inglourious Basterds, Eastern Promises, Jerry Maguire dhe Dr. Seuss How the Grinch Stole Christmas. KPM ka bërë vlerësimin e kontratave të deponuara ka gjetur se TRING TV ka të drejta që filmat për të cilët është ankuara Pala Ankuese, t'i bartë edhe në territorin e Kosovës.

11. Bordi për Ankesa gjithashtu gjen se Pala Ankuese, sërish me datën 16 prill 2015, ka paraqitur 9 ankesa ndaj të njëjtëve operatorë kabllorë (ELEKTRA, EURINA, ORANGE NET, NEGE NET, KUMANOVA, VISTA, KUJTESA NET, EGC DHE ART MOTION) me pretendimin se këta operatorë kabllorë bartin përmbajtje programore, përkatësisht filma, pa të drejta autoriale: Hannibal, Fast and Furious 4, Modele origjinale, Postieri, The Big Lebowski, I love Radio Rock dhe Bowfinger.
12. Pala Ankuese, me datën 22 prill 2015, ka paraqitur edhe dymbëdhjetë ankesa kundër operatorëve kabllorë: ELEKTRA, KUJTESA, EGC, ORANGE NET, KUMANOVA, NEGE NET, ARTMOTION, TRING TV, DRINIA NET, DREAM, MAX TV, GALAKTIKA, me pretendim të transmetimit të përmbajtjeve programore, përkatësisht filmave, nëpërmjet platformës TRING TV pa të drejta autoriale: Public Enemies, Robin Hood, People I Know, Mr. Bean's Holiday, I Now Pronounce You Chuck and Larry, Jeff, Who Lives at Home.
13. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 24 prill 2015, duke u bazuar në ankesat e Palës Ankuese të datës 16 prill 2015 dhe të datës 22 prill 2015 u ka dërguar shkresë të gjithë operatorëve kabllorë për t'i deponuar në KPM kontratat përmes të cilave dëshmojnë se TRING TV ka të drejtë që këto përmbajtje (filma) t'i bartë në territorin e Kosovës.
14. Me datën 24 prill 2015, Palës Ankuese i është dërguar letër duke e njoftuar për veprimet që i ka ndërmarrë KPM pas ankesave të datës 16 prill 2015. Po ashtu, KPM, në këtë shkresë e ka informuar IPKO-n që në kontratat e tyre të deponuara në KPM nuk gjenden filmat: Postieri dhe I love Radio Rock, të cilët janë përmendur në ankesat e tyre si përmbajtje e transmetuar pa të drejtë autoriale.
15. Bordi për Ankesa gjen se KPM, me datën 30 prill 2015 ka pranuar përgjigje nga TRING TV në lidhje me kërkesën e KPM-së të datës 24 prill 2015, duke sjellë kontratat për filmat e kërkuar. KPM ka bërë vlerësimin e kontratave të deponuara dhe ka gjetur se TRING TV ka të drejta që të gjithë filmat e kërkuar t'i transmetojë edhe në territorin e Kosovës.
16. Gjithashtu edhe me datën 20 maj 2015, Pala Ankuese është njoftuar lidhur me ankesat e datës 16 prill 2015, duke e informuar që TRING TV i është përgjigjur kërkesës së KPM-së, duke siguruar kontratat edhe për filmat e përmendur në ankesat e datës 16 prill 2015: Hannibal, Fast and Furious 4 Model Originale, The Big Lebowski, I Love Radio Rock dhe Bowfinger.

### Vendimi

17. Bordi për Ankesa, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura nga KPM dhe Pala Ankuese konstatoi se, Vendimi i Komisionit të KPM-së është marr në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Ligjin e KPM-së dhe gjenden faktike të konstatuar pas vlerësimit të marrëveshjeve të deponuara.



18. Bordi për Ankesa duke u bazuar në faktin se KPM ka bërë vlerësim të drejtë të ligjit material, procedural dhe vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike (vlerësimin e kontratave të operatorëve kabllorë për bartjen e platformës TRING TV), në pajtim me nenin 36, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së vërteton Vendimin e KPM-së Nr. 2015/42, si të drejtë dhe të ligjshëm

#### Arsvetimi


19. Bordi për Ankesa në seancën dëgjimore të mbajtur më 27 gusht 2015, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e të gjitha fakteve, shkresave të lëndës dhe dokumentet tjera relevante.
20. Bordi për Ankesa gjen se Vendimi i KPM-së është i bazuar në fakte, në shqyrtimin e hollësishëm që i është bërë kontratave të sjella nga platforma TRING TV, me ç'rast është vërtetuar se operatorët kabllorë ndaj të cilëve janë bërë ankesat nga Pala Ankuese, kanë të drejtë t'i bartin programet e platformës së TRING TV edhe në territorin e Republikës së Kosovës.
21. Bordi për Ankesa ka gjetur se përkundër ankesës së Palës Ankuese se për të gjitha ankesat është nxjerrë një Vendim i vetëm, KPM është bazuar në vëllimin e madh të ankesave të pranuar nga Pala Ankuese dhe për arsye procedurale ka nxjerrë një Vendim, duke u bazuar në faktin se e lejon natyra e rastit, pasi që si për nga objekti ashtu edhe subjekti, të gjitha ankesat kanë qenë identike dhe kanë paraqitur një çështje juridike.
22. Bordi për Ankesa gjen KPM në mënyrë të vazhdueshme ka shqyrtuar ankesat e palës ankuese dhe se Vendim i KPM-së për refuzimin e ankesave të palës ankuese është marrë në pajtim me ligjin procedural, material dhe gjendjen faktike të konstatuar pas vlerësimit të kontratave të palës ankuese dhe palëve të cilat bartin platformën TRING TV në territorin e Kosovës.

Bordi për Ankesa gjithashtu gjen se KPM ka vlerësuar drejtë të drejtën e operatorëve kabllorë për të bartur përmbajtjen e platformës TRING TV në Kosovë, pasi që këta të fundit kanë siguruar marrëveshjet valide për të drejtën e autorit, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 2, paragrafi 2.1.1 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:


*“Të licencuarit i kërkohet të veprojnë në pajtueshmëri me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta si dhe ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojnë leje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale që i bartë në listën e tij programore. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që transmetohen nga sateliti”.*

### Rishikim procedural

23. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM- në.
24. Palët në vendim mund të dorëzojnë kërkesën për rishikim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
25. Inicimi i rishikimit procedural nuk ndalon zbatimin e vendimeve të Komisionit të KPM-së ashtu siç mbështeten apo modifikohen nga Bordi.



Daut Krasniqi  
Kryetar, Bordi për Ankesa




data





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Me të cilin vërtetoj se nga Zyra e Komisionit të Pavarur për Media kam pranuar shkresën:

With this I confirm receipt the official document from the Office of Independent Media Commission:

**Emri dhe numri i referencës:**  
**Name and reference number:**  
**Ime i broj referencije**

**IPKO TELECOMMUNICATIONS L.L.C**  
**Robert Erzin**

**Prishtinë**

**Prishtinë**

**Ref: 1509/1094/BA/dk**

**data 14.09.2015**

**date:**

**datum**

Bujar Buzata

Emri i përfaqësuesit të KPM

Name of IMC representative

Buzata

Nënshkrimi i përfaqësuesit të KPM

Signature of IMC representative

Asmon Binot

Emri i pranuesit dhe data  
Name of Recipient and date

Vendi/Place

Just

Nënshkrimi i pranuesit data dhe ora  
Signature of Recipient date and time

Data dhe ora /Date and time: